

## KOMUNIKATË PËR MEDIA

### Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (IÇP), TM4 2025

24.02.2026

Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (IÇP) për tremujorin e katërt (TM4) 2025.

## Çmimet e prodhimit më të larta në TM4 2025 sesa në TM3 2025

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të prodhimit në Kosovë (IÇP) pati një ngritje prej 0,1 % ndërmjet TM4 2025 dhe TM3 2025. Kurse, krahasuar TM4 me të njëjtën periudhë të vitit paraprak (TM4 2024) çmimet e prodhimit u ngritën në një mesatare prej 5,4 %.

### Tremujori i katërt 2025 – Tremujori i tretë 2025 0,1 %

Çmimet e prodhimit në Kosovë patën një ngritje prej 0,1 % ndërmjet TM4 2025 dhe TM3 2025. Ngritjet më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (3,2 %); prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (2,3 %); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara – thurëse (2,1 %); shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara (1,1 %); xeherorët dhe guroret e tjera (0,8 %); prodhimi i pijeve (0,4 %); energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (0,2 %); prodhimi i produkteve minerale jometalike (0,2 %); prodhimi i tekstilit (0,2 %); nxjerrja e xehes së metalit (0,1 %); prodhimi i veshjeve (0,1 %); prodhimi i produkteve kimike (0,1 %).


Ngritja u neutralizua nga rënia e çmimeve te: prodhimi i metaleve (-3,7 %); veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave (-1,2 %); prodhimi tjetër p.k.t. (-1,1 %); prodhimi i mobilie (-0,3 %); prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (-0,3 %); dhe përpunimi i produkteve ushqimore (0,7 %).

### Tremujori i katërt 2025 – Tremujori i katërt 2024 5,4 %

Çmimet e Prodhimit në Kosovë u ngritën në një mesatare prej 5,4 % ndërmjet TM4 2025 dhe TM4 2024. Ngritje më të mëdha sipas degëve të veprimtarive ekonomike vërehen te: energjia elektrike, gazi, avulli dhe furnizimi me ajër të kondicionuar (20,9 %); prodhimi i mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmë-rimorkiove (9,0 %); prodhimi i veshjeve (8,6 %); përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutike (8,1 %); prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t (7,6 %); prodhimi tjetër p.k.t. (6,4 %); prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës (6,2 %); shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara (5,9 %); prodhimi i pajisjeve elektrike (5,0 %); prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve (3,7 %); prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara – thurëse (3,2 %); prodhimi i tekstilit (1,4 %); përpunimi i produkteve ushqimore (2,2 %); grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë (1,7 %); nxjerrja e xehes së metalit (0,7 %); prodhimi i produkteve minerale jometalike (0,6 %); prodhimi i produkteve kimike (0,2 %).

Ngritja u neutralizua nga ulja e çmimeve te: prodhimi i metaleve (-11,6 %); veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve (-4,4 %); prodhimi i mobilieve (-0,8 %); prodhimi i pijeve (-0,7 %); prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës (-0,4 %); dhe xeherorët dhe guroret tjera (-0,1 %).

#### Zhvillimi i IÇP, Tremujori i parë 2021 –Tremujori i katërt 2025 (2021=100)



**Peshat, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit (2021=100) dhe ndryshimet tremujore dhe vjetore në %**

| Sektor   | Grupet | Nomenklatura e veprimtarive ekonomike<br>NACE rev.2                                                                                                 | Peshat  | TM 4 - 2025 | TM 4 - 2025 | TM 4 - 2025 |
|----------|--------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------|-------------|-------------|-------------|
|          |        |                                                                                                                                                     |         | Ø2021=100   | TM 3 - 2025 | TM 4 - 2024 |
|          |        | Gjithsej IÇP                                                                                                                                        | 1000.00 | 121.3       | 0.1         | 5.4         |
| <b>B</b> | 05     | Nxjerrja e qymyrit dhe linjiteve                                                                                                                    | 0.23    | 100.0       | 0.0         | 0.0         |
|          | 07     | Nxjerrja e xehes së metalit                                                                                                                         | 5.44    | 85.9        | 0.0         | 0.7         |
|          | 08     | Xeherorët dhe guroret tjera                                                                                                                         | 36.03   | 121.6       | 0.8         | -0.1        |
| <b>C</b> | 10     | Përpunimi i produkteve ushqimore                                                                                                                    | 182.27  | 131.3       | -0.1        | 2.2         |
|          | 11     | Prodhimi i pijeve                                                                                                                                   | 74.14   | 112.4       | 0.4         | -0.7        |
|          | 12     | Prodhimi i produkteve të duhanit                                                                                                                    | 1.85    | 185.6       | 0.0         | 0.0         |
|          | 13     | Prodhimi i tekstilit                                                                                                                                | 7.14    | 110.7       | 0.2         | 1.4         |
|          | 14     | Prodhimi i veshjeve                                                                                                                                 | 7.29    | 121.2       | 0.1         | 8.6         |
|          | 15     | Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurës                                                                                                      | 3.39    | 117.5       | 0.0         | 0.0         |
|          | 16     | Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie: prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara - thurëse | 28.59   | 126.4       | 2.1         | 3.2         |
|          | 17     | Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës                                                                                                        | 11.10   | 152.6       | 3.2         | 6.2         |
|          | 18     | Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara                                                                                                       | 13.47   | 131.1       | 1.1         | 5.9         |
|          | 20     | Prodhimi i produkteve kimike                                                                                                                        | 19.08   | 117.3       | 0.1         | 0.2         |
|          | 21     | Përpunimi i produkteve dhe preparateve farmaceutike                                                                                                 | 1.25    | 114.2       | 0.0         | 8.1         |
|          | 22     | Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës                                                                                                     | 72.00   | 110.0       | 0.0         | -0.4        |
|          | 23     | Prodhimi i produkteve minerale jometalike                                                                                                           | 121.90  | 112.5       | 0.2         | 0.6         |
|          | 24     | Prodhimi i metaleve                                                                                                                                 | 32.77   | 98.7        | -3.7        | -11.6       |
|          | 25     | Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike, përveç makinerisë dhe pajisjeve                                                                         | 60.72   | 113.3       | -0.3        | 3.7         |
|          | 27     | Prodhimi i pajisjeve elektrike                                                                                                                      | 5.32    | 105.9       | 0.0         | 5.0         |
|          | 28     | Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t                                                                                                           | 3.85    | 128.1       | 2.3         | 7.6         |
|          | 30     | Prodhimi i mjeteve motorike (të transportit), rimorkiove dhe gjysmërimorkiove                                                                       | 0.62    | 108.6       | 0.0         | 9.0         |
|          | 31     | Prodhimi i mobilie                                                                                                                                  | 52.94   | 116.7       | -0.3        | -0.8        |
|          | 32     | Prodhimi tjetër p.k.t.                                                                                                                              | 6.99    | 104.0       | -1.1        | 6.4         |
| <b>D</b> | 35     | Energjia elektrike, gaz, avulli dhe furnizimi me ajr të kondicionuar                                                                                | 227.97  | 133.6       | 0.2         | 20.9        |
| <b>E</b> | 36     | Grumbullimi, trajtimi dhe furnizimi me ujë                                                                                                          | 11.45   | 118.2       | 0.0         | 1.7         |
|          | 38     | Veprimtaritë e grumbullimit, trajtimit dhe asgjësimit të mbeturinave; rikuperimi i materialeve                                                      | 12.21   | 62.5        | -1.2        | -4.4        |

Për më shumë informata lidhur me Indeksin e Çmimeve të Prodhimit (IÇP) për TM4 2025, vizitoni: <https://ask.rks-gov.net/Themes/PricesAndInflation>